



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 78, datë 04.03.2021

PËR

SKUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...}  
DHE PËRJASHTIMIN E SAJ NGA PROCEDURAT E EMËRIMITNË  
GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 04.03.2021, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me riverifikimin e një prej kriterëve formale të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatorja, znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatës znj. {...} nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë,

VËREN

I. TË DHËNA PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË KANDIDATES

1. Me Vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar edhe si Këshilli) ka vendosur:

*“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile....”*

*3. Afati i kandidimit është pesë muaj nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.*

2. Vendimi i Këshillit si më lart për hapjen e procedurës së kandidimit për në Gjykatën e Lartë, janë publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 28.02.2020, përfshirë dhe një njoftim publik për hapjen e kësaj procedure. Pas publikimit të vendimit, afati e kandidimit ka filluar të ecë nga dita e nesërme, pra nga data 29.02.2020, duke përfunduar ky afat në datë 30.07.2020.

3. Me Vendimin nr. 243, datë 09.07.2020, Këshilli ka vendosur:

*“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”....”*

3. Afati i kandidimit është deri më datë 30.07.2020”.

4. Vendimi i Këshillit për hapjen e procedurës së kandidimit për në Gjykatën e Lartë sipas pikës 3, të këtij relacioni, është publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 09.07.2020, përfshirë dhe një njoftim publik për hapjen e kësaj procedure. Pas publikimit të vendimit, afati e kandidimit ka filluar të ecë nga dita e nesërme, pra nga data 10.07.2020.

5. Brenda afateve të kandidimit për dy pozicionet e lira si më lart, pra atë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 87, datë 26.02.2020 dhe ato në fushën e të drejtës penale të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 243, datë 09.07.2020, ka kandiduar edhe gjyqtarja znj. {...}(më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

6. Me Vendimin nr. 268, datë 07.08.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, si dhe Vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243, nr. 244 dhe nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

*“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020 (në fushat e të drejtës administrative dhe të së drejtës civile), me Vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243 dhe nr. 244, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës penale), si dhe me Vendimin nr. 245, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës administrative), të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

*2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ...7.Për kandidaten znj. {...} - relatore znj. Marçela Shehu; ...”.*

7. Më datë 07.08.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatores së kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuarpërrjashtimine relatores së caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

8. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatoren e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtari tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Po të njëjtën datë, bazuar në pikën 8, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

10. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidatja duhet ta dorëzonte, jo më vonë se data 11.09.2020, pranë ILDKPKI-së. Kjo e fundit nuk e ka njoftuar Këshillin, sikundër i është kërkuar, në rastin e mospërmbylljes së këtij detyrimi nga ana e kandidatës, çka nënkupton dorëzimin nga kandidatja të formularit të deklaratës së pasurisë.

11. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 13.08.2020, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për kandidaten znj. {...}. Në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidatës, në kuadër të ngritjes në detyrë, në kushtet kur kandidatja është subjekt rivlerësimi “*ex officio*” sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr. 84/2016 “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, proces ky që për atë nuk kishte përfunduar, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Shkresën nr. 3870 prot., datë 11.08.2020, i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj kandidatës, bazuar kjo në Vendimin 75/2019, ku përcaktohet se: *“Kandidatët që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016 dhe janë në procedurë e sipër rivlerësimi ose për të cilët kjo procedurë nuk ka filluar ende, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës nga Këshilli, sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. Vendimi i Këshillit për kualifikimin ose jo për këta kandidatë do të mbështetet në vendimin e dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Në këtë rast, Këshilli i kërkon Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit për këta kandidatë. ...”* (Kreu X, Seksioni B, pika 2).

12. Me qëllim plotësimin në kohë të pozicioneve të lira në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e kësaj të fundit funksionale në një kohë sa më të shpejtë, Këshilli i Lartë Gjyqësor konsideroi zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira. Kështu, për të filluar në kohë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, çka do të mundësonte më pas përmbylljen e procedurës së renditjes dhe të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, pra finalizimin e procedurës së ngritjes në detyrë përmes propozimit përkatës për emërim, Këshilli konsideroi ndarjen në dy faza të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit. Në fazën e parë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t’i nënshtroheshin verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit, në logjikën sipas të cilës kandidati që nuk i plotësonte këto kritere do të duhej të skualifikohej nga kandidimi, duke mos u bërë kështu ai pjesë e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, pra për të lehtësuar këtë proces dhe synuar përfundimin në kohë të tij. Ndërsa në fazën e dytë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t’i nënshtroheshin verifikimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës. Vetëm pas verifikimit të të gjithë kriterëve të kandidimit, Këshilli do të vendoste përfundimisht për kualifikimin ose jo të çdo kandidati.

13. Bazuar në sa u parashtrua në pikën 12, të këtij relacioni, në pikën 9, të Vendimeve të Këshillit nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, pra në vendimet për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira ku ka kandiduar edhe znj. {...}, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr. 87, datë 26.02.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen ..., si mëposhtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Ndërsa në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr. 243, datë 09.07.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen ..., si mëposhtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës penale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronja “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtyre dy vendimeve, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

14. Në respektim të vendimeve si më lart të Këshillit, sa i përket verifikimit të tre kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

14.1 Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me Shkresën nr. 4010/1 prot., datë 01.09.2020, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}.

14.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht të “përvojës specifike profesionale” të kandidates në fushat e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionet e lira ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile dhe atë të së drejtës penale, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarës, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykatën e Apelit Vlorë, informacioni iu kërkua të trija këtyre gjykatave, për të përcaktuar qartë përvojën specifike të kandidates në fushën e të drejtës civile dhe në fushën e të drejtës penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrëska përcjellë informacionin e kërkuar me Shkresën nr. 2783 prot., datë 14.08.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3924 prot., datë 18.08.2020. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorëka përcjellë

informacionine kërkuar në rrugë elektronike me datë 14.08.2020. Kurse Gjykata e Apelit Vlorë ka përcjellë informacionine kërkuar në rrugë elektronike më datë 08.09.2020.

15. Në përfundim të verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit për znj. {...}, bazuar në të dhënat e grumbulluara, me Vendimin nr. 329, datë 17.09.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

*“1. Verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 243, datë 09.07.2020, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.*

*2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 243, datë 09.07.2020”.*

16. Mbas vendimit sipas pikës 15, të këtij relacioni, me Vendimin nr. 337, datë 24.09.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

*“I. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë.*

*II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë: ... 5. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili. ...”.*

## **II. TË DHËNA MBI VIJIMIN E PROCEDURËSË VERIFIKIMIT TË KANDIDATES**

17. Nga ana tjetër, për kandidaten znj. {...} ka vijuar procedura e verifikimit për kriteret e kandidimit, pikërisht të pasurisë dhe të figurës, ndërsa Këshilli ka qenë në pritje të përfundimit me përparësi të procesit të rivlerësimit kalimtar për kandidaten. Gjatë kësaj procedure, me Shkresën nr. 1204 prot., datë 03.02.2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njoftoi Këshillin e Lartë Gjyqësor për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për kandidaten znj. {...}, si subjekt rivlerësimi “*ex officio*” sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe se, me Vendimin nr. 341, datë 01.02.2021, ka vendosur: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë”.*

18. Mbas shqyrtimit të të dhënës së njoftuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, si dhe të dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit, në Mbledhjen e datës 24.02.2021, bazuar në pikën 12, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, Komisioni i

Zhvillimit të Karrierës vendosi që kandidatja znj. {...} të njoftohej për gjetjen e kësaj procedure në lidhje me një prej kritereve të kandidimit për emërim/ngritjen në detyrëne gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, pikërisht atë të *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”*.

19. Më datë 24.02.2021, në rrugë elektronike, kandidates i është dërguar Njoftimi “Për gjetjen e procedurës së verifikimit”.

20. Në Njoftimin “Për gjetjen e procedurës së verifikimit”, kandidates i është bërë e ditur se gjatë procedurës së verifikimit ishte evidentuar një rrethanë, e cila, bazuar në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mund të passillte skualifikimin/ndalimin e kandidimit të saj për emërimin/ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, e konkretisht ajo e *“pasjesmasë disiplinore në fuqi”*.

21. Lidhur me rrethanën që mund të passillte skualifikimin/ndalimin e kandidimit të saj për emërimin/ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, në Njoftimin “Për gjetjen e procedurës së verifikimit”, kandidates i është bërë e ditur se *“Shkarkimin nga detyra”*, me Vendimin nr. 341, datë 01.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, përbënte masë disiplinore në kuptim të neneve 58, pika 1, shkronja “c”, 61 dhe 62, të Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ndërkohë që, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohej se: *“Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës dhe që nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”*. Kurse në pikën 7, Seksioni B, Kreun X, të Vendimit 75/2019, nxjerr, ndër të tjera, edhe për zbatimin e neneve 32 dhe 48, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohej se: *“7. Kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, të cilët nuk janë konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe kur ndaj atij vendimi është paraqitur ankim, nuk pranohen të kandidojnë dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin”*.

22. Nëpërmjet Njoftimit “Për gjetjen e procedurës së verifikimit”, kandidatesi është bërë e ditur se, në respektim të të drejtës për t’u dëgjuar të subjektit në një procedurë administrative, si dhe në zbatim të Vendimit 75/2019 (shkronja “a”, pika 12, Seksioni B, Kreu VI), kishte të drejtën për të paraqitur shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, si dhe çdo dokumentacion mbështetës sipas vlerësimit të saj, ndërsa afati për paraqitjen e shpjegimeve dhe dokumenteve mbështetës ishte 5 (pesë) ditë dhe fillonte nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit.

23. Bashkë me Njoftimin “Për gjetjen e procedurës së verifikimit”, kandidates i është dërguar edhe Shkresa nr. 1204 prot., datë 03.02.2021, e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

24. Brenda afatit të caktuar, më datë 01.03.2021, kandidatjaka depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, shpjegimënë lidhje me gjetjen e procedurës së verifikimit.

25. Në shpjegimet e saj për gjetjen e procedurës së verifikimit, kandidatja ka parashtruar se:

*“Në vijim, ndjehem e detyruar të jap shpjegimet e mia, në lidhje me Njoftimin “Për gjetjen e procedurës së verifikimit” të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, pasi në rast të mosparaqitjes së këtyre shpjegimeve, pretendimet e mia nuk mund t’i parashtroj në mbrojtje të interesave të mia personale në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, dhe më tej në Gjykatën e Strasbourgut.*

*Siç jeni në dijeni, me besimin se kontributi im do të ishte sado pak i vlefshëm, në kushtet kur Gjykata e Lartë prej disa vitesh nuk funksionon, kam paraqitur kërkesë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 243 datë 09.07.2020.*

*Me Vendimin nr. 329 datë 17.09.2020 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:*

*1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile , të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 243 datë 09.07.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqënies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.*

*2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e lire në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 243, datë 09.07.2020.*

*Ky Vendim më është komunikuar elektronikisht në datë 22.09.2020.*

*Në datën 25.02.2021, në rrugë elektronike më është komunikuar Njoftimi “Për gjetjen e procedurës së verifikimit”, nga përmbajtja e së cilës rezulton që sipas Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pas Vendimit nr. 341 datë 01.02.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është vlerësuar se ky vendim, përbën masë disiplinore në kuptim të neneve 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, 62 të Ligjit nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

*Kjo gjetje më është komunikuar duke më dhënë njëkohësisht e drejta për të dhënë shpjegime.*

*Vlerësoj se konstatimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vjen në kundërshtim me një vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendim i cili nuk është revokuar dhe në bazë të të cilit është hetuar dhe është konstatuar se sipas dokumentacionit të administruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ndaj meje nuk ka masë disiplinore në fuqi.*

*Në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Vetëm kandidatët të cilët kalojnë*

verifikimin e pasurisë dhe figurës dhe që nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”. Sipas të njëjtit ligj, masat disiplinore, referuar nenit 105 të tij, merren nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Siç është konstatuar sipas dokumentacionit të administruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ndaj meje nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Në lidhje me Vendimin nr. 341 datë 01.02.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me të cilin është vendosur shkarkimi im nga detyra, vendim i cili nuk është arsyetuar dhe nuk është publikuar, për pasojë ende nuk kam vendosur nëse do ta ankimoj ose jo, pra nuk ka marrë formë të prerë, nuk përbën “masë disiplinore në fuqi” në kuptim të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në asnjë dispozitë të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” nuk referohet tek ligji nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në nenin 164 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili nuk ka marrë formë të prerë, nuk çënon statusin e magjistratit. Pra, aktualisht kam statusin e magjistratit, dhe ndaj meje nuk ka masë disiplinore në fuqi, të marrë nga organi i caktuar me ligj për marrjen e masave disiplinore.

Përsa i përket pikës 7, Seksioni B, Kreun X, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, në të cilën përcaktohet se: “7. Kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, të cilët nuk janë konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe kur ndaj atij vendimi është paraqitur ankim, nuk pranohen të kandidojnë dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin”, në vlerësimin tim vjen në kundërshtim me nenin 48 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe me nenin 118 të Kushtetutës.

Në nenin 118/2 të Kushtetutës parashikohet se: “2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.”

Në nenin 49/14 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “14. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë: a) kriteret për etikën dhe veprimtarinë profesionale ndërmjet kandidatëve me pikë të barabarta vlerësimi; b) kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë; c) procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta; ç) zbatimin dhe përshtatjen e parashikimeve të këtij neni për pozicionet e lira të përkohshme.”

Pra, neni 48 i të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka autorizuar Këshillin e Lartë Gjyqësor të nxjerrë akte nënligjore vetëm në çështjet e parashikuara në pikën 14 të tij, jo për çështje të tjera, apo për



*vendosjen e kriterëve të reja, interpretimin e zgjeruar të kriterëve, etj. Për pasojë vendosja e një kriteri që nuk e parashikon ligji, nuk ka qënë brenda fushës së kompetencave që ligji i ka njohur Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo “gjetje” e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, nuk ka lidhje me kriteret që neni 48 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka përcaktuar, por është në tejkalim të tyre, pasi rrjedh nga një akt nënligjor i cili përmban parashikime tej kompetencës dhe diskrecionit që ligji ka parashikuar për organin që ka nxjerrë këtë akt.*

*Vlerësimi im i parashtruar më lart, siç edhe e kam përmendur në fillim të shpjegimeve të mia, është i detyruar të jepet prej meje. Siç edhe kam parashtruar vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nuk është publikuar ende, nuk jam në dijeni të përmbajtjes së tij, dhe për pasojë mund të përbëjë shkak ankimi prej meje, fakti që vendimi cënon të drejta të mia, të mbrojtura nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (neni 8), pretendime të cilat nuk mund t'i parashtroj në rast se nuk i kam ngritur para juridiksionit të brendshëm. Qëllimi im, në asnjë rast, nuk është të bëhem pengesë për vazhdimin e procedurave të ngritjes së Gjykatës së Lartë, kjo duket qartë edhe nga fakti i kandidimit tim, pavarësisht se pjesa më e madhe e magistratëve, në proces rivlerësimi me të drejtë kanë hezitur, përkundrazi, kam marrë guximin të kandidoj pikërisht për t'i dhënë një ndihmë, sado pak, ngritjes së institucioneve. Por heqja dorë prej meje nga kandidimi, në këtë fazë, apo mos dhënia e shpjegimeve dhe kundërshtimeve, do të më hiqte të drejtën e ngritjes së pretendimeve në të ardhmen, në lidhje me pasojat e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në jetën time profesionale dhe familjare”.*

26. Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit për kandidaten znj. {...}, në lidhje me kriterin e kandidimit “*të mos ketë masë disiplinore në fuqi*”, përcaktuar nga pika 8, e nenit 48, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, relatorja i çështjes ia parashtroi rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

### **III. SHQYRTIMI NGA KOMISIONI**

27. Në Mbledhjen e datës 02.03.2020, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për kandidaten znj. {...}, në lidhje me kriterin e kandidimit “*të mos ketë masë disiplinore në fuqi*”, përcaktuar nga pika 8, e nenit 48, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe duke vlerësuar se aktualisht, për kandidaten, verifikohet një e dhënë e re në lidhje me një prej kriterëve formale të kandidimit, mbi të cilën, Këshilli, kryesisht, bazuar në nenet 113 dhe 114 të Kodit të Procedurave Administrative, me qëllimin rivendosjen e ligjshmërisë, duhet të shqyrtojë ligjshmërinë e Vendimit të tij nr. 329, datë 17.09.2020, e dhënë kjo, që nga ana tjetër, mund të passjell edhe skualifikimin e kandidates nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për shfuqizimin e Vendimit të tij nr. 329, datë 17.09.2020 dhe skualifikimin e kandidates e përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë ose për vijimin e procedurës së verifikimit për të.

#### IV. SHQYRTIMI NGA KËSHILLI

28. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi u njoh me relacionin përkatës të relatores së çështjes, si dhe materialet e grumbulluara gjatë verifikimit, konstaton se për kandidaten, aktualisht, është verifikuar një rrethanë që çon në përfundimin e mospërmbushjes prej saj të një prej kriterëve të kandidimit, pikërisht atij të *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”*, përcaktuar në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar.

29. Rrethana e konstatuar rishtazi lidhet me faktin e *“shkarkimit nga detyra”* të kandidates, me Vendimin nr. 341, datë 01.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pra të organit të ngarkuar nga Kushtetuta për kryerjen e procesit të rivlerësimit. *“Shkarkimi nga detyra”* përbën masë disiplinore në kuptim të legjislacionit në fuqi, çka përcaktohet shprehimisht në nenin 58, pika 1, sikundër edhe në nenin 60, të Ligjit nr.84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, ligj i cili rregullon procesin e rivlerësimit dhe masat disiplinore që mund të ndërmerren në kuadër të tij, përfshirë edhe ndaj gjyqtarëve subjekt rivlerësimi *“ex officio”* sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

30. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka në konsideratë se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për dhënien e masës disiplinore *“shkarkim nga detyra”*, është një vendim pasojat juridike të të cilit fillojnë menjëherë me njoftimin e tij, duke përbërë ai shkak për ndërprerjen e menjëhershme të ushtrimit të detyrës nga gjyqtari ose prokurori subjekt rivlerësimi ndaj të cilit ai është marrë. Në pikën 7, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se: *“Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë”*.

31. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se fakti që kandidatja subjekt rivlerësimi nuk është njohur ende me arsyetimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndaj të cilit gëzon të drejtën e ankimit gjyqësor përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nuk ndikon në fillimin e menjëhershëm të efekteve të masës disiplinore *“shkarkim nga detyra”* të dhënë ndaj saj. Të drejtat e subjektit të rivlerësimit pas dhënies së vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit përcaktohen në nenin 62, të Ligjit nr.84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, ku parashikohet se: *“1. Subjekti i rivlerësimit, i cili ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit për masën disiplinore për shkarkimin nga detyra, pezullohet ex lege nga detyra e tij në pritje të vendimit të Kolegjit të Apelimëve. Gjatë periudhës së pezullimit atij i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj, në përputhje me nenin F, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës.2. Në këtë rast, subjekti i rivlerësimit nuk ka të drejtë të shqyrtojë dhe të gjykojë çështje. ...”*.Pra, pavarësisht se gjyqtari i *“shkarkuar nga detyra”* prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit vijon të ruajë statusin e magjistratit deri në shqyrtimin e çështjes nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në rastin kur paraqitet ankim gjyqësor, ai ligjërisht është nën efektet e një mase disiplinore, ndërsa i ndalohej ushtrimi i detyrës.

32. Fakti që masa disiplinore “*shkarkim nga detyra*” ndaj gjyqtarës kandidate nuk është marrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk mund të çojë në mosekzistencën e kësaj mase disiplinore. Me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me ndryshimet e vitit 2016, parashikoi ngritjen e sistemit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, një proces ky i jashtëzakonshëm dhe tranzitor, që kryhet nga organet e pavarura kushtetuese dhe që ka për qëllim kontrollin e ligjshmërisë së pasurisë, të pastërtisë së figurës dhe të pasjessëaftësive minimale profesionale. Në kuadër të këtij procesi ligjor, Kushtetuta dhe ligji i dalë në zbatim të saj (Ligji 84/2016), kanë konsideruar që, në raport me objektin e rivlerësimit kalimtar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vepron si organ disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nisur nga kjo, vendimmarrja e këtij organi disiplinor, i dhënë brenda kompetencave të tij, nuk mund të anashkalohej dhe të mos merret në konsideratë, përfshirë edhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Në Vendimin nr.2, datë 18.01.2017, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “22. *I gjithë procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si pjesë e paketës së reformës në drejtësi, edhe pse është një masë e jashtëzakonshme dhe me karakter të përkohshëm, është ngritur nga kushtetutëbërësi në rang kushtetues, duke parashikuar institucionet që do të kryejnë këtë proces, kompetencat e tyre, si edhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve dhe garancitë që ata gëzojnë. Qëllimi i përcaktimit të kompetencave të këtyre organeve në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kushtetutë do të thotë se asnjë institucion nuk mund të marrë këto kompetenca apo t'i anashkalojë ato*”.

33. Në kushtet kur për kandidaten verifikohet një e dhënë e re në lidhje me një prej kriterëve formale të kandidimit, çka afekton në tërësi ligjshmërinë e Vendimit nr. 329, datë 17.09.2020, me qëllimin rivendosjen e situatës së ligjshmërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi që, kryesisht, të shfuqizojë këtë vendim të tij, bazuar në nenet 113 dhe 114 të Kodit të Procedurave Administrative. Kështu, në nenin 113, të këtij Kodi, përcaktohet se: “1. *Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, ...2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja për të shkuarën, ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm për të ardhmen. Anulimi dhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm. 3. Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e pare*”. Ndërsa në nenin 114, të këtij Kodi, përcaktohet se: “1. *Me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 108, të këtij Kodi, një akt administrativ i paligjshëm mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin rivendosjen e ligjshmërisë... ”.*

34. Nga ana tjetër, pikërisht për shkak të të dhënës së re të verifikuar për kandidaten, në kushtet kur ajo aktualisht rezulton të këtë një masë disiplinore në fuqi, çka përbën pengesë për pranimin në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë, sipas pikës 8, të nenit 48, Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për skualifikimin e kandidates dhe përjashtimin nga procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira ku ajo ka kandiduar.

35. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson po ashtu se në rastin konkret nuk është i nevojshëm vijimi i procedurës së verifikimit të kandidatës për kriterete të kandidimit, përsa kohë, sipas ligjit, mosplotësimi qoftë edhe i një kushti ose kriteri të vetëm kandidimi pasjell skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedurat e ngritjes në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë.

## **V. KONKLUZIONE**

36. Sa më lart, duke vlerësuar se aktualisht, për kandidaten, verifikohet një e dhëne e re në lidhje me një prej kriterëve formale të kandidimit, bazuar në nenet 113 dhe 114 të Kodit të Procedurave Administrative, me qëllimin rivendosjen e ligjshmërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin për shfuqizimin e vendimit të tij të mëhershëm të fazes së verifikimit paraprak, prat ë Vendimit nr. 329, datë 17.09.2020, si një akt administrativ që aktualisht klasifikohet si i paligjshëm.

37. Në vijim, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se jemi para rastit të skualifikimit dhe përjashtimit të kandidatës znj. {...} nga procedurat e emërimin në Gjykatën e Lartë, për shkak të mosplotësimin prej saj të një prej kriterëve të kandidimit për një pozicion në Gjykatën e Lartë, konkretisht atë “*të mos ketë masë disiplinore në fuqi*”, përcaktuar nga pika 8, e nenit 48, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në nenin 136 dhe në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “c” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61, pika 2, shkronja “c”, në nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, në nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, në nenin 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 113 dhe 114, të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 58, pika 1, shkronja “c”, në nenet 61 dhe 62, të Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “dh”, si dhe në Kreun XI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

## **V E N D O S I**

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 329, datë 17.09.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...}, të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen

*në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87 datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 243 datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.*

2. Skualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 243, datë 09.07.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
4. Kundër vendimit mund të paraqitet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**